



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 768/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Afijete Sada Glllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Gëzim Tahiraj nga Iniciativa Qytetare GPD, me seli në Drenas, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.768/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Gëzim Tahiraj nga Iniciativa Qytetare GPD, me seli në Drenas, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.768/2021, nga Gëzim Tahiraj, nga radhët e Iniciativës Qytetare GPD, me seli në Drenas, në të cilën pretendon se ka pasur keqpërdorim dhe manipulim të votave në vendvotimin 0322E/02D në Qikatovë të Vjetër në Shkollën “Dëshmorët e Drenicës”.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi apelin, vlerësoi se:

#### **Apeli është i pabazuar**

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatojë se ka pasur manipulime të votave, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mungesë të votave, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Gëzim Tahiraj, nga radhët e Iniciativës Qytetare GPD, me seli në Drenas, nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet

në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave.

Nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.768/21 më datë 07.11.2021



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.